

**STATUT
PRATHAM**

Ravi Kumar
Ravi Kumar

Livia Riza
Livia

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I- Emri, Forma, Selia, Kohëzgjatja

Neni 1 - Emri i Shoqërisë

Neni 2 - Forma Ligjore

Neni 3 - Selia e Shoqërisë

Neni 4 - Kohëzgjatja

KAPITULLI II - Objekti

Neni 5 - Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë

Neni 6 - Ndryshimi i objektit

KAPITULLI III - Kapitali Themeltar, Ortaket, Transferimi i Kuotave dhe pjesëve të tyre

Neni 7 - Kapitali i regjistruar i Shoqërisë

Neni 8 - Te drejtat dhe detyrimet e Ortakut/eve

Neni 9 - Transferimi i Kuotave dhe pjesëve të tyre

KAPITULLI IV - Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve

Neni 10 - Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

Neni 11 - Kuorumi dhe Vendim - Marrja

KAPITULLI V - Administratori

Neni 12 - Emërimi, Kohëzgjatja e Mandatit dhe Shkarkimi

Neni 13 - Të Drejtat dhe Detyrimet e Administratorit

KAPITULLI VI - Administrimi Financiar i Shoqërisë

Neni 14 - Eksperti Kontabël i Autorizuar

Neni 15 - Viti Financiar

Neni 16 - Mbajtja e Llogarive

Neni 17 - Llogaritja dhe Shpërndarja e Fitimit

KAPITULLI VII -Ndryshimi i Formës Ligjore, Prishja, Likuidimi


Neni 18 - Ndryshimi i Formës Ligjore

Neni 19 - Prishja e Shoqërisë

Neni 20 - Likuidimi

KAPITULLI VIII - Të ndryshme

Neni 21 - Ligji i Zbatueshëm dhe Gjykata Kompetente

Ravi Kumar


Livia Riza


KAPITULLI I

Emri, Forma, Selia, Kohëzgjatja

Neni 1

Emri i Shoqërisë

- 1.1 Emri i Shoqërisë është **PRATHAM** ("Shoqëria"), ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi "sh.p.k.", i cili përfaqëson formën ligjore të saj.
- 1.2 Në të gjitha dokumentat, faturat, reklamimet, botimet dhe çdo dokument tjetër korrespondence të lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyra e dërgimit, në veçanti kur u drejtohen palëve të treta, emri i saj do të ndiqet ose do të shoqërohet nga fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "sh.p.k.", si dhe do të përmbajnë të dhënat me poshtë:
- a. numrin unik të identifikimit të biznesit (NUIS);
 - b. formën ligjore të Shoqërisë;
 - c. adresën e selisë së Shoqërisë;
 - ç. të dhëna nëse Shoqëria është në likuidim; dhe
 - d. vlerën kapitalit të nënshkruar dhe të paguar të Shoqërisë.

Neni 2

Forma Ligjore

- 2.1 Shoqëria është person juridik shqiptar dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, të organizuar në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar ("Ligji i Shoqërive Tregtare").

Neni 3

Selia e Shoqërisë

- 3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Nikolla Jorga, Ndërtesa 9, Hyrja 4, Njësia Bashkiake Nr. 7, 1001, Tiranë, Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë.
- 3.3 Shoqëria mund të hapë, filiale, degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Kohëzgjatja


- 4.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pacaktuar.

KAPITULLI II

Objekti

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë

Ravi Kumar


Livia Rizo


- 5.1 Tregti dhe Shpërndarje, Import, Eksport, Shitje me shumicë, Shitje me pakicë, Dropshipping, Tregti elektronike, Franchising, Shërbime të shpërndarjes dhe zinxhirit të furnizimit, Ushqime dhe Pije, Bar, Kafe / Çajtores, Restorant / Lokal, Fast Food, Furrë buke / Pastiçeri, Shërbime catering, Kamion ushqimi / Ushqim rruge, Kuzhinë virtuale, Shërbime dërgese ushqimore, Produkte shtëpiake dhe të konsumit, Pajisje shtëpiake, Mobilje dhe Dekor shtëpie, Produkte pastrimi, Enë kuzhine, Ndriçim dhe llamba, Jorganë dhe çarçafë, Shërbime lavanderie. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi, i cili nuk është i ndaluar nga ligji
- 5.2 Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, Shoqëria mund:
- të kryejë çdo lloj aktiviteti në raport me objektin dhe për të favorizuar atë.
 - të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, dhënie-marrje me qira, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore që mund të konsiderohen si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara më sipër;
 - të kryejë çdo aktivitet në lidhje me publikimin, marketingun apo reklamimin;

Neni 6

Ndryshimi i objektit

- 6.1 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë, në respektim të dispozitave urdhëruese të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe parashikimeve të këtij Statuti.


KAPITULLI III

Kapitali i Regjistruar, Ortakët, Transferimi i Kuotave dhe pjesëve të tyre

Neni 7

Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë

- 7.1 Kapitali i Shoqërisë është në total **100,000 Lekë** dhe zotërohet nga ortakët:
- Ravi Kumar, shtetas Indian, lindur më 15.08.1981, në Indi, mbajtës i letërnjoftimit me numër 839319121 dhe numër personal I138150041, me adresë në: Rruga Nikolla Jorga, Ndërtesa 9, Hyrja 4, Njësia Bashkiake Nr. 7, 1001, Tiranë, Shqipëri, zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkruara në shumën 80,000 lekë, të cilat përfaqësojnë 80% të kapitalit të Shoqërisë;
 - Livia Riza, shtetase shqiptare, lindur në Pogradec, më 10.03.1997, mbajtëse e letërnjoftimit me numër 038882016 dhe numër personal J75310067W me adresë në: Rruga Ferit Xhajko, Tiranë, zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkruara në shumën prej 20,000 lekë, të cilat përfaqësojnë 20% të kapitalit të Shoqërisë;
- 7.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute në para. Kapitali përbëhet nga dy kuota me vlerë **100,000 lekë (njëqind mijë) lekë** të nënshkruar nga ortakët.
- 7.3 Zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me propozim të Administratorit, vetëm në rastin kur Shoqëria mund të pësojë humbje të tilla që ta bëjnë të domosdoshëm këtë zvogëlim.

Ravi Kumar


Livia Riza


7.4 Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë do të zmadhohet dhe zvogëlohet në përputhje me dispozitat urdhëruese të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe parashikimeve të këtij Statuti.

Neni 8

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakut/ëve

- 8.1** Ortakët zotërojnë 100% të kapitalit të Shoqërisë. Të gjitha vendimet e tij do të regjistrohen sipas rendit kronologjik Regjistrin e Vendimeve të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose fshihen. Një vendim i paregjistruar në këtë Regjistër është i pavlefshëm. Administratori/ët e Shoqërisë është/janë përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Vendimeve.
- 8.2** Ortakë të Shoqërisë janë vetëm ata të cilët kanë nënshkruar dhe shlyer kontribute, si dhe zotërojnë Kuota në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë.
- 8.3** Ortakët e Shoqërisë nuk përgjigjen për detyrimet e Shoqërisë dhe mbulojnë personalisht humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributet e ortakëve përbëjnë Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë.
- 8.4** Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe ose detyrime të tjera, me karakter vetjak, të Ortakëve të saj.
- 8.5** Secili prej ortakëve ka dhe ushtron të drejtën e votës në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve (Asambleja e Përgjithshme) në proporcion me vlerën e kontributeve përkatëse dhe përqindjes pjesëmarrëse në kapitalin e Shoqërisë, të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë, sikundër të drejta të tjera të parashikuara nga ky Statut dhe/ose Ligji për Shoqëritë Tregtare.
- 8.6** Ortakët kanë të drejtë që, pas kërkesës së tyre me shkrim drejtuar Shoqërisë, të marrin brenda afateve të arsyeshme kohore, informacione dhe të dhëna në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë si dhe kopje të çdo dokumentacioni financiar apo ligjor që i përket Shoqërisë.

Neni 9

Transferimi i Kuotave dhe pjesëve të tyre të Kapitalit

- 9.1** Kuota përkatëse ose çdo pjesë e saj është lirisht e transferueshme midis ortakëve.
- 9.2** Çdo transferimi kuotës ose çdo pjesë të saj nga një ortak tek persona të tretë që nuk janë ortakë ekzistues në Shoqëri, përmes shitblerjes apo çdo formë tjetër ligjore me kundër shpërblim, i nënshtrohet këtyre rregullave:
- Ortaku Transferues, duhet t'i njoftojë Shoqërisë kalimin e Kuotës (nëse kuota do të kalohet në tërësi) ose vlerën e kontributeve dhe përqindjen përkatëse të pjesëmarrjes së tij në kapitalin e Shoqërisë (nëse do të kalohet vetëm një pjesë e Kuotës përkatëse) e që do të transferohet, çmimin e shitjes në rast shitjeje, blerësin potencial si dhe të dhëna të tjera që vlerësohen thelbësore në lidhje me transferimin e Kuotës ose një pjesë të saj
 - Transferimi duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve brenda 1 (një) muaji nga dita e njoftimit. Në rast se Asambleja nuk ka bërë të ditur vendimin e saj brenda afatit 1 (një) muaj, miratimi quhet i dhënë.

Ravi Kumar


Livia Rize


- c. Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes së kuotës ose pjesëve të saj nga Ortaku Transferues proporcionalisht me përqindjen e zotëruar në kapitalin e shoqërisë dhe këta ortakë të tjerë duhet ta ushtrojnë të drejtën e parablerjes brenda 30 ditëve nga marrja e komunikimit të vullnetit të Ortakut Transferues për të transferuar kuotat.
- d. Në rast se Asambleja refuzon transferimin, brenda 1 (një) muaji nga data e refuzimit, ortakët duhet të blejnë Kuotën ose pjesë të saj të propozuara për transferim, proporcionalisht me përqindjen e pjesëmarrjes dhe vlerës së kontributeve të nënshkruara dhe të zotëruara në kapital, përveç rastit kur bien dakord ndryshe.
- e. Në rast se asnjë ortak nuk është i interesuar të blejë Kuotën ose pjesë të saj, atëherë Asambleja duhet të vendosë nëse:
 - Kuota ose pjesë të saj do t'i shiten një personi të tretë, të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, sipas çmimit të propozuar nga Ortaku Transferues;
 - Kuota ose pjesë të saj do të blihen nga Shoqëria me qëllim zvogëlimin e kapitalit. Në këtë rast çmimi i transferimit do të vendoset nga një ekspert kontabël i pavarur i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme;


9.3 Transferimi i Kuotës ose pjesëve të saj tek personat e tretë jashtë rradhëve të Ortakëve të Shoqërisë, përmes dhurimit apo formave të tjera të ngjashme i nënshtrohet këtyre rregullave :

- a. Ortaku Transferues, duhet t'i njoftojë Shoqërisë kalimin e Kuotës (nëse kuota do të kalohet në tërësi) ose vlerën e kontributeve dhe përqindjen përkatëse të pjesëmarrjes së tij në kapitalin e Shoqërisë (nëse do të kalohet vetëm një pjesë e Kuotës përkatëse) që do të transferohen përmes dhurimit apo formave të tjera të ngjashme, identitetin e përfutuesit të dhurimit si dhe të dhëna të tjera që vlerësohen thelbësore në lidhje me këtë lloj transferimi.
- b. Transferimi përmes dhurimit apo formave të tjera të ngjashme, do t'i nënshtrohet miratimit të Asamblesë së Përgjithshme, e cila jep miratimin brenda 1 (një) muaji nga njoftimi i Ortakut Transferues.
- c. Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes së kuotës ose pjesëve të saj nga Ortaku Transferues proporcionalisht me përqindjen e zotëruar në kapitalin e shoqërisë dhe këta ortakë të tjerë duhet ta ushtrojnë të drejtën e parablerjes brenda 30 ditëve nga marrja e komunikimit të vullnetit të Ortakut Transferues për të transferuar kuotat.
- d. Në rast se Asambleja refuzon transferimin, brenda 1 (një) muaji nga data e refuzimit, duhet të autorizojë administratorin që të blejë Kuotën ose pjesët e saj nga Ortaku Transferues me qëllim anulimin e tyre dhe zvogëlimin e Kapitalit të Regjistruar. Çmimi i blerjes do të përcaktohet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme sipas parashikimeve të këtij Statuti.

9.4 Transferimi i Kuotave duhet të kryhet me një akt të shkruar sipas kërkesave të ligjit.

9.5 Çdo transferim i kryer në kundërshtim me rregullat e sipërpërmendura është i pavlefshëm, dhe Ortaku Transferues do të jetë përgjegjës kundrejt Ortakëve të tjerë dhe Shoqërisë për dëmet e shkaktuara.

9.6 Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i Kuotës transferohen tek çdo zotërues i ri i kësaj Kuote.

Ravi Kumar


Livia Rize



KAPITULLI IV

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

Neni 10

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi vendimmarrës i Shoqërisë dhe përbëhet nga të gjithë ortakët e saj.
- 10.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të shprehë mendimin e tij dhe të ushtrojë të drejtën e një vote të barabartë me vlerën e kontributeve të tij dhe përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë.
- 10.3 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nga një person tjetër, jo domosdoshmërisht ortak, me anë të një prokure të posaçme, të noterizuar dhe të pajisur me vulë Apostile nëse është rasti. Prokura e Posaçme mund të jepet vetëm për një Mbledhje, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite. Prokura e Posaçme duhet të përmbajë tagrat dhe mënyrën e votimit të përfaqësuesit në Asamblenë e Përgjithshme.
- 10.4 Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret të paktën një herë në vit, brenda muajit Qershor, me qëllim diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin e bilancit vjetor të vitit ushtrimor të mëparshëm. Asambleja e Përgjithshme mund të mbledhet në një vendndodhje të ndryshme nga selia e Shoqërisë, brenda Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj.
- 10.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori ose nga çdo njëri prej Ortakëve, në përputhje me kërkesat e nenit 84 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 10.6 Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet me letër rekomande me njoftim marrjeje ose me postë elektronike në adresën elektronike të Ortakëve, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e Asamblesë.
- 10.7 Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme duhet të përmbajë informacion mbi çështjet që do të diskutohen dhe mbi të cilat do të merret vendim (rendi i ditës), vendin, orën dhe datën e thirrjes.
- 10.8 Asambleja e Përgjithshme do të quhet e thirrur dhe e mbledhur rregullisht edhe nëse nuk respektohen të gjitha formalitetet e thirrjes, nëse të gjithë ortakët që përfaqësojnë 100 % Kapitalin e Shoqërisë janë të pranishëm në mbledhje ose të përfaqësuar me prokurë, dhe shprehen dakord për të zhvilluar Mbledhjen e Asamblesë pavarësisht parregullsive në thirrjen e saj.
- 10.9 Asambleja e Përgjithshme drejtohet nga Administratori, i cili emëron një sekretar për mbajtjen e procesverbalit të Mbledhjes. Administratori, në cilësinë e Kryetarit të Mbledhjes, ka kompetenca të plota për të kontrolluar prokurat dhe rregullsinë e tyre dhe për të përcaktuar nëse asambleja është mbledhur rregullisht dhe nëse është arritur kuorumi i domosdoshëm për të marrë vendime të vlefshme. Kryetari ka gjithashtu të drejtën për të drejtuar diskutimet dhe përcaktuar metodat dhe procedurat e votimit.

Ravi Kumar



Livie Rize


- 10.10 Ortakët pranojnë dhe bien dakord që të marrin Vendime Qarkulluese me Shkrim, pa qenë nevoja për t'u thirrur në Asamble. Draft-Vendimet e propozuara së bashku me dokumentacionin mbështetës do t'u dërgohen Ortakëve me postë të regjistruar, fax, e-mail ose mënyra të tjera elektronike të sigurta. Ortakët do të votojnë në lidhje me Draft-Vendimet, brenda një periudhe prej 15 ditësh nga dita që ju është dorëzuar ky Draft dhe do të miratojnë Vendimet Qarkulluese duke i kthyer, me postë të regjistruar, Administratorit të Shoqërisë, një kopje të firmosur. Vendimi Qarkullues me shkrim do të konsiderohet i miratuar nëse aprovohet nga shumica e kërkuar nga Ligji për Shoqëritë Tregtare dhe ky Statut dhe Administratori shpall rezultat e tij.
- 10.11 Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbale të cilat nënshkruhen nga Kryetari i Mbledhjes dhe sekretari. Procesverbalit i bashkëlidhet dokumenti i thirrjes së Mbledhjes së Asamblesë i konfirmuar nga Ortaku dhe evidenca e pjesëmarrjes së ortakëve. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve depozitohen në Regjistrin e Vendimeve të Shoqërisë. Vendimet e paregjistruara janë të pavlefshme.
- 10.12 Nëse Shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme, të përcaktuara në këtë Statut dhe në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, ushtrohen nga ortaku i vetëm.

Neni 11

Kuorumi dhe Vendim-Marrja

- 11.1 Në rast vendimesh të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm Ortakët zotërues të më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së Kuoromit në thirrjen e parë, Asambleja mund të mbledhet përsëri me të njëjtin rend dite brenda dhe jo me vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga thirrja e parë. Në rast vendimesh të zakonshme, këto të fundit merren me votën pro të shumicës së Ortakëve të pranishëm apo të përfaqësuar.
- 11.2 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të zakonshme për çështjet e mëposhtme:
- Vendosjen e politikave tregtare;
 - Mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët e Shoqërisë, përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecursisë ;
 - Emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve.
 - Emërimi dhe shkarkimi i ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likuiduesve;
 - Përcaktimin e shpërblimit të Administratorëve, ekspertëve kontabël, audituesve dhe likuiduesve;
 - Përfaqësimin në gjykatë të Shoqërisë dhe në procedura të tjera kundër Administratorëve;
 - Miratimin e transferimit të Kuotave të Shoqërisë tek palët e treta, jashtë rradhëve të ortakëve;
 - Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - Çështje të tjera që parashikohen nga Ligji ose Statuti

Ravi Kumar


Livia Rizo


11.3 Në rast vendimesh të jashtëzakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm Ortakët zotërues të 80% (tetëdhjetë përqind të kapitalit të Shoqërisë). Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të

mungesës së Kuoromit në thirrjen e parë, Asambleja mund të mbledhet përsëri me të njëjtin rend dite brenda dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga thirrja e parë. Në rast vendimesh të jashtëzakonshme, këto të fundit merren me votën pro të $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e Ortakëve të pranishëm apo të përfaqësuar.

11.4 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të jashtëzakonshme për çështjet e mëposhtme:

- a. Ndryshimin e Statutit të Shoqërisë;
- b. Zmadhimin ose zvogëlimin e Kapitalit, apo realizimin e shpërndarjes ose të emetimit të kuotave, ose çfarëdo lloj garancie tjetër, ose dhënien e çdo opsiioni apo të drejte nënshkrimi ose konvertimin e çdo instrumenti në kuota apo garanci;
- c. Shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- d. Themelimin, blerjen ose shitjen e Filialeve, Degëve apo Zyrave të Përfaqësimit të Shoqërisë;
- e. Riorganizimin e Shoqërisë në një formë tjetër, shpërndarjen, shndërrimin, bashkimin, shkrirjen, ndarjen, prishjen apo likuidimin e Shoqërisë;

KAPITULLI V

Administratori

Neni 12

Emërimi, Kohëzgjatja e Mandatit dhe Shkarkimi

12.1 Shoqëria do të administrohet nga:

- Livia Riza, shtetase shqiptare, lindur në Pogradec, më 10.03.1997, mbajtëse e letërnjoftimit me numër 038882016 dhe numër personal J75310067W me adresë në: Rruga Ferit Xhajko Tiranë, Shqipëri, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh.
- Ravi Kumar, shtetas Indian, lindur më 15.08.1981, në Indi, mbajtës i letërnjoftimit me numër 839319121 dhe numër personal I13815004I, me adresë në: Rruga Nikolla Jorga, Ndërtesa 9, Hyrja 4, Njësia Bashkiake Nr. 7, 1001, Tiranë, Shqipëri madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh.


12.2 Administratorët do të emërohen me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

12.3 Administratori mund të shkarkohet, në çdo kohë, me miratimin e Asamblesë së Ortakëve.

Neni 13

Të Drejtat dhe Detyrimet e Administratorit/eve

13.1 Administratori/ët janë përgjegjës për çështjet e përditshme të Shoqërisë dhe përfaqësojnë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët në përputhje me dispozitat e Statutit dhe/ose ligjit të zbatueshëm.

Ravi Kumar


Livia Riza


13.2 Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit (eve) janë:

- a. Të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme;
- b. Të menaxhojë aktivitetin tregtar të Shoqërisë duke implementuar strategjitë, politikat dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- c. Të sigurohet që pasqyrat financiare të mbahen në mënyrën e duhur: Të firmosë bilanci vjetor, llogaritë e konsoliduara dhe raportet e performancës, së bashku me rekomandimet për Asamblenë e Përgjithshme për shpërndarjen e fitimeve;
- d. Veprimet e ndërmarra nga administratori Livia Riza kërkojnë nënshkrimin e të dy administratoreve për vlera tregtare të transaksionit që tejkalon shumën prej 300,000 Lekë.
- e. Veprimet e ndërmarra nga administratori Livia Riza për çdo tjetërsim të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshëm që disponon Shoqëria kërkojnë vendim nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të cilësuar.
- f. Çdo veprim tjetër i ndërmarrë nga shoqëria do të kërkojë nënshkrimin e një Administratori përveç se nëse vendoset specifikisht në një vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- g. Të krijojë një sistem paralajmërues në lidhje me ngjarjet që kërcënojnë ekzistencën e Shoqërisë;
- h. Depozitim të të dhënave të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit sipas rastit;
- i. Të raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me implementimin e politikave të biznesit dhe realizimin e transaksioneve me rëndësi të veçantë për Shoqërinë, të cilat janë autorizuar paraprakisht prej Asamblesë së Ortakëve;
- j. Të zbatojë detyra të ngarkuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve dhe Ligji sipas rastit.

13.3 Administratori(ët) mbikëqyrin dhe siguronjnë që zyrtarët, agjentët, të punësuarit, auditorët dhe këshilltarët e Shoqërisë të veprojnë me kujdesin e duhur dhe të mbrojnë sa më mirë interesat e Shoqërisë.

KAPITULLI VI

Administrimi Financiar i Shoqërisë

Neni 14

Auditues Ligjor


14.1 Asambleja e Përgjithshme emëron auditues ligjor, në rastet kur një gjë e tillë kërkohet nga legjislati në fuqi.

14.2 Ekspertët duhet të kryejnë funksionet audituese në përputhje me legjislatin shqiptar.

Neni 15

Viti Financiar

15.1 Viti ekonomik-financiar fillon në ditën e parë të muajit Janar dhe përfundon në ditën e 31-të të muajit Dhjetor të secilit vit. Viti i parë ekonomik-financiar fillon me themelimin e Shoqërisë.

Ravi Kumar


Livia Riza


Neni 16
Mbajtja e Llogarive

16.1 Shoqëria do të mbajë llogaritë në lekë dhe, nëse kërkohet, edhe në monedhë të huaj.

Neni 17
Llogaritja dhe Shpërndarja e Fitimit

17.1 Fitimi i Shoqërisë përcaktohet në bazë të bilancit të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme. Shpërndarja e fitimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me Statutin, dhe me ligjet e zbatueshme.

17.2 Nga fitimet vjetore, do të caktohet një fond rezervë në përputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar për fondin rezervë të detyrueshëm.

17.3 Në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Shoqëria mund të shpërndajë fitimin tek Ortakët vetëm nëse pas shpërndarjes së dividendit:

- a. asetet e Shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e kësaj të fundit, dhe
- b. Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm.

KAPITULLI VII

Ndryshimi i Formës Ligjore, Prishja, Likuidimi

Neni 18
Ndryshimi i Formës Ligjore


18.1 Forma ligjore e Shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me dispozitat përkatëse të Legjislacionit Shqiptar dhe këtë Statut.


18.2 Shoqëria e re do të përmbushë të gjitha procedurat ligjore të regjistrimit në Shqipëri.

Neni 19
Prishja e Shoqërisë

19.1 Shoqëria mund të priset në rrethanat e mëposhtme:

- a. Si pasojë e përfundimit të kohëzgjatjes për të cilën ishte themeluar;
- b. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- c. Me hapjen e një procedure falimentimi apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentit;
- d. Në rast se objekti i aktivitetit bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të Shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare të Shoqërisë
- e. Në rast të pavlefshmërisë së Shoqërisë pas themelimit dhe regjistrimit të saj në QKB siç është parashikuar në nenin 3/1 të Ligjit për Shoqëritë;
- f. Për arsye të tjera të parashikuara nga Ortakët në çdo kohë.

Ravi Kumar


Livie Rizo


19.2 Administratori regjistron prishjen e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me nenin 43 të Ligjit nr.9723, datë 3.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Në rast se prishja e Shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të Ligjit nr. 9723, datë 3.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ia njoftimin vendimin kësaj të fundit për regjistrim.

Neni 20 **Likuidimi**

20.1 Në rast prishjeje në gjendjen e aftësisë paguese Shoqëria duhet të likuidohet.

20.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve emëron një ose më shumë likuidatorë të cilët do të hartojnë raportin përfundimtar mbi aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë, dhe mbi procedurat dhe kohën e duhur për likuidimin.

20.3 Në përfundim të procedurave të likuidimit, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve do të vendosë mbi bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesit dhe përfundimin e procesit të likuidimit.

20.4 Pas shlyerjes së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive të mbetura, likuiduesit do t'u shpërndajë ortakëve aktivet e mbetura në përpjesëtim me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në kapitalin e Shoqërisë.

KAPITULLI VIII

Të ndryshme

Neni 21 **Ligji i Zbatueshëm dhe Gjykata Kompetente**


21.1 Çdo çështje tjetër, e cila nuk është parashikuar në këtë statut, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

21.2 Ortakët bien dakord që çdo ose të gjitha mosmarrëveshjet që lindin në lidhje me vlefshmërinë, interpretimin apo zbatimin e Statutit të zgjidhen me mirëkuptim mes tyre dhe në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata Shqiptare.

Më datë 25 gusht 2025, në Tiranë, u hartua dhe u nënshkrua, me vullnetin e lirë të ortakëve, ky Statut i Shoqërisë PRATHAM shpk, në 3 kopje në Shqip, me vlerë të njëjtë ligjore.

ORTAKËT

RAVI KUMAR

Ravi Kumar


LIVIA RIZA

Livia Riza
